



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 518, datë 03.11.2021

PËR
MOSPRANIMIN E KËRKESËS SË GJYQTARES {...}, PËR PËRJASHTIMIN NGA
LISTA E GJYQTARËVE QË CAKTOHEN PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE
GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO
KU USHTRON FUNKSIONIN NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 97 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në paragrafin VIII, pika 6, të Vendimit nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, pasi shqyrtoi kërkesën dhe materialet bashkëlidhur asaj, paraqitur prej gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, znj. {...},

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}, e cila ushtron funksionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për përjashtimin nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta.
2. Ky vendim t’i komunikohet gjyqtares znj. {...}, e cila ushtron funksionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR